

Mbrojtja e konsumatorit të Energjisë në Shqipëri

*Nga kontributi i Anëtares së Bordit të Entit Rregullator të
Energjisë (ERE) për Shqipërinë*



**Fuqizimi i Rregullatorëve të Mesdheut për një të ardhme të
përbashkët energjetike**



Përmbledhje

Ky dokument mundëson informacion shterues mbi masat për mbrojtjen e konsumatorit dhe kanalet e komunikimit të vendosura në Shqipëri nga Enti Rregullator i Energjisë për Shqipërinë (ERE) "ERE".

Ai hedh dritë mbi masat që u ndërmorën nga Rregullatori Shqiptar gjatë krizës energjetike për të mbrojtur konsumatorët në nevojë nga rritja e çmimeve të energjisë. Përveç kësaj, ky dokument ofron informacion të detajuar mbi kanalet e komunikimit të përdorura, mekanizmat e vendosur për të fuqizuar konsumatorët për të marrë vendime të informuara, faturat e energjisë dhe procedurat e ankesave. Ai po ashtu ndihmon politikën e gjerë të energjisë në Shqipëri, diversifikimin e burimeve të energjisë dhe përpjekjet e vendosura në vend për të përmirësuar integrimin e tregut rajonal. Së fundi, ai parashtron sfidat kryesore që has ERE për të mbrojtur në mënyrë efektive konsumatorët në nevojë në Shqipëri dhe se si MEDREG po e mbështet ERE-n për t'i kapërcyer ato.

Mirënjohje

Ky raport bazohet në informacionet e dhëna nga Znj.Erjola Sadushi, e cila aktualisht është Anëtare në Bordin drejtues të Entit Rregullator të Energjisë për Shqipërinë (ERE) ndërsa më parë ka mbajtur postin e Drejtoreshës së Drejtorisë Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve. Znj.Sadushi është gjithashtu nënkryetare e Grupit të Punës së Konsumatorëve pranë MEDREG. Kontributi i saj u bë me dije nëpërmjet një podkasti të regjistruar në Janar 2024 me titull “Mbrojtja e konsumatorit të energjisë në Shqipëri dhe Algjeri”

MEDREG falenderon Znj. Sadushi për kontributin e saj të vlefshëm.

Përfundim nga përgjegjësia

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e MEDREG dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European.

Rreth MEDREG

MEDREG është Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë Mesdhetare, që bashkon 28 rregullatorë nga 23 vende, që përfshijnë Bashkimin European, Ballkanin dhe rajonin MENA.

Rregullatorët e Mesdheut punojnë së bashku për të promovuar një harmonizim më të madh të tregjeve dhe legjislacioneve rajonale të energjisë, duke kërkuar integrimin progresiv të tregut në pellgun euro-mesdhetar. Nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet anëtarëve, MEDREG synon të nxisë të drejtat e konsumatorëve, eficientë të energjisë, investimet dhe zhvillimin e infrastrukturës, bazuar në sisteme energjetike të mbrojtura, të sigurta, me kosto efektive dhe të qëndrueshme për mjedisin. MEDREG vepron si një platformë që ofron shkëmbim informacioni dhe asistencë për anëtarët e saj, si dhe aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve përmes webinarëve, sesioneve të trajnimit dhe seminareve (workshopeve). Sekretariati i MEDREG ndodhet në Milano, Itali.

Për më shumë informacion, ju lutem vizitoni www.medreg-regulators.org.

Përcaktimi i kontekstit të sektorit të energjisë elektrike për Shqipërinë	4
1. Masat e ndërmarra nga ERE për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë nga rritja e çmimeve të energjisë.....	4
2. Kanalet e komunikimit që përdoren për të informuar dhe fuqizuar konsumatorët.....	5
3. Bashkëpunimi me palët e interesuara.....	7
4. Sigurimi që faturat të kuptohen në mënyrën e duhur.....	7
5. Diversifikimi i burimeve të energjisë dhe integrimi i tregut rajonal.....	8
6. Sfidat dhe kufizimet kryesore për të mbrojtur konsumatorët në nevojë dhe roli i MEDREG në mbështetjen e ERE për këtë qëllim.....	9

Përcaktimi i kontekstit të sektorit të energjisë elektrike për Shqipërinë

Nevojat e Shqipërisë për energji sigurohen kryesisht nga hidrocentralet. Vendi mbështetet plotësisht në energjinë e rinovueshme. Megjithëse Shqipëria është e pasur me burime ujore, ajo nuk mund të plotësojë të gjitha nevojat e vendit për energji elektrike. Pra, të qenit energji e bazuar në burime hidrike, dhe kur nuk ka reshje, kërkon importimin e energjisë. Kompanitë më të mëdha ajo prodhuese KESH, OST dhe OSSH janë kompani shtetërore.

1. Çfarë masash ndërmori Rregullatori Shqiptar gjatë krizës energjetike për të mbrojtur konsumatorët në nevojë nga rritja e çmimeve të energjisë?

Legjislacioni primar përcakton elementet bazë për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë konceptin, kriteret për identifikimin e konsumatorëve në nevojë si dhe kërkesat për operatorët e licencuar. Sipas dispozitave të ligjit, qeveria Shqiptare përcakton kriteret dhe procedurat për marrjen e statusit të konsumatorit në nevojë. Kriteret hartohen nga Ministria e Çështjeve Sociale, Ministria e Energjisë dhe Ministria e Financave. Konsultimet me palët e interesuara vijojnë.

Pavarësisht fazës në të cilën ndodhet dokumenti i mësipërm, skema ekzistuese e kompensimit të energjisë në Shqipëri ofron mbrojtje për konsumatorët në nevojë bazuar në tre lloje të kompensimit të energjisë:

1. Kompensimi që mbulon efektet e heqjes së pragut për konsumin e energjisë elektrike deri në 300 kWh.
2. Kompensim për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, për nivelin e konsumit 200 kWh. Konsumatorët familjarë mund të aplikojnë për të dyja masat.
3. Kompensimi për personat me status të veçantë invaliditeti.

ERE ka miratuar një dokument të rëndësishëm lidhur me mbrojtjen specifike të rrethanave të ndërprerjes së energjisë elektrike për konsumatorët në nevojë.

Vlen të theksohet se Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të:

1. Sigurojë shërbimin e pandërprerë për konsumatorët në nevojë, kur konsumatori ose ndonjë anëtar i familjes së tij përdor pajisje për mbështetjen e jetës (life support) të cilat operojnë me energji elektrike.
2. Furnizuesi i energjisë elektrike nuk duhet të ndërpresë furnizimin për mospagesë kur konsumatori përfiton nga statusi “konsumator në nevojë”, përveç rasteve kur në 12 muajt e mëparshëm furnizuesi ka ofruar dy herë një plan pagese të përshtatshme dhe konsumatori ka refuzuar.
3. Furnizimi me energji elektrike nuk duhet të ndërpritet në ditët kur furnizuesi nuk ofron shërbimin për konsumatorët në qendrat e kujdesit ndaj klientit, etj, siç përcaktohet në rregullore.

Besojmë se është një dokument i rëndësishëm për mbrojtjen e konsumatorit që përcakton rregulla të qarta për kriteret dhe procedurat që duhen ndjekur nga Furnizuesi i Shërbimit Universal të Energjisë Elektrike në rastin e furnizimit me energji elektrike për Konsumatorët në Nevojë.

Gjatë periudhës së krizës energjetike dhe rritjes së çmimeve, si qeveria ashtu edhe Autoriteti Rregullator Kombëtar (ERE) zbatuan masa që do të mbronin konsumatorët. Këto masa janë projektuar për të lehtësuar disa nga ndikimet financiare si rezultat i rritjes së kostove të energjisë. Ndërsa kishte disa iniciativa, besojmë se është e rëndësishme të theksohen disa masa që patën një ndikim veçanërisht të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e konsumatorëve.

- Në Tetor 2021, Qeveria e Shqipërisë vendosi shpalljen e gjendjes së emergjencës në sektorin e energjisë elektrike, e cila pas ndryshimeve/shtyrjeve të ndryshme qëndroi në fuqi deri në Dhjetor 2023.

- Një masë tjetër e ndërmarrë nga Qeveria ishte edhe VKM për Detyrimin e Shërbimit Publik. Kështu, qeveria Shqiptare vendosi që e gjithë energjia elektrike e prodhuar nga KESH (prodhuesi publik dhe më i madhi në vend) t'i kalojë ofruesit të shërbimit universal. KESH gjithashtu ka detyrimin t'u shesë energjinë me çmim të reduktuar konsumatorëve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (të lidhur me 20/10/6 KV).

- KESH gjithashtu duhet të mbulojë nevojat energjetike të OST për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe t'i shesë energjinë e tepërt të mbetur furnizuesit universal nëse është e nevojshme.

- Gjithashtu, qeveria Shqiptare dha garancinë shtetërore për OSHEE; operatori publik i sistemit të shpërndarjes dhe furnizuesi universal i energjisë elektrike; (Shuma prej 100 milionë eurosh është dhënë për vitin 2021 dhe 100 milionë euro shtesë për vitin 2022) për të garantuar importin e energjisë elektrike me çmime të rritura.

Sipas Ligjit për Detyrimin e Shërbimit Publik, prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike u kërkohet të shesin energjinë elektrike me një çmim të rregulluar gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Masat shtesë të zbatuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të sektorit të energjisë elektrike përfshijnë mbështetjen financiare nga qeveria, e cila mbulon 70% të kostos për instalimin e paneleve diellore në ndërtesa për ngrohjen e ujit.

Masat e tjera përfshijnë një kërkesë që institucionet shtetërore të reduktojnë konsumin deri në 15%, me gjoha të vendosura nëse nuk përmbushen.

Gjatë krizës energjetike, ERE mori një sërë masash për të përballuar situatën në fjalë. Për të llogaritur kostot e rritura të operatorëve të rrjetit, u rritën tarifat e rrjetit. Gjithashtu, ERE nisi një rishikim të kostove të parashikuara për konsumatorët që përfitojnë Shërbimin Universal. Është e rëndësishme të theksohet se nuk ka pasur ndryshime në çmime për këta konsumatorë.

Për t'u siguruar që individët ishin të mirëinformuar për situatën dhe se si mund të ndikojë tek ata, broshura informuese u publikuan në platformat e mediave sociale si dhe në faqen zyrtare të internetit. Kjo i lejoi konsumatorët të qëndrojnë të përditësuar dhe të marrin vendime të informuara bazuar në nevojat e tyre individuale.

Përveç rritjes së tarifave të rrjetit dhe ofrimit të burimeve informative për konsumatorët, ERE vendosi gjithashtu dispozita që synojnë të garantojnë përmbushjen e detyrimeve të furnizuesit, duke përfshirë:

- akses të lehtë në shërbimet e ofruara për individët me aftësi të kufizuara; dhe
- informacion i detyrueshëm për konsumatorin që detajon të drejtat dhe kushtet që lidhen me çmimet e furnizimit me energji elektrike, informacion në lidhje me mjetet e disponueshme për shlyerjen e borxheve të papaguara dhe mbi të drejtën e tyre për të adresuar ankesën e tyre pranë institucioneve të ngarkuara për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve - përfshirë vetë ERE, Avokatin e Popullit dhe Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit.

2. Si komunikoni për të edukuar dhe angazhuar konsumatorët fundorë drejt zakoneve të qëndrueshme?

ERE ka vendosur në zbatim Strategjinë e Komunikimit që mundëson komunikimin eficient me të gjitha palët e interesuara përmes një qasje të hapur dhe të detajuar. Për ERE është e rëndësishme të sigurojë që konsumatorët janë të mirëinformuar për të drejtat e tyre dhe legjislacionin në fuqi, ndërkohë që vazhdojmë tu ofrojmë konsumatorëve informacionin përkatës se si ata të përdorin në mënyrë eficiente energjinë elektrike për të reduktuar kostot e tyre. Ne e kuptojmë që ky informacion duhet të paraqitet sa më qartë, për të shmangur kompleksitetin dhe konfuzionin për konsumatorin.

Për të arritur këtë objektiv, kemi dhënë shembuj konkret për të ilustruar pikat tona. Që do të thotë kemi shpjeguar se si çdo pajisje në shtëpi ndikon në nivelet e konsumit dhe kemi theksuar se si përdorimi i gabuar mund të çojë në konsum më të lartë. Përveç kësaj kemi përshkruar mënyra alternative të sigurimit të energjisë, siç është të bëhemi një "prosumer (konsumator prodhues)" në vend që të mbështetemi vetëm tek furnizuesit.

Po ashtu ne mendojmë që fuqizimi i konsumatorit për tu bërë vetë-prodhues është një aspekt i rëndësishëm për promovimin e përdorimit të energjisë në mënyrë eficiente. Përmes përpjekjeve tona, ne synojmë të ofrojmë udhëzime të detajuara se çfarë duhet të bëjnë individët për të marrë në kontroll prodhimin e tyre të energjisë.

Qasja jonë është projektuar jo vetëm për të edukuar konsumatorët por edhe për t'i inkurajuar ata që të marrin vendime më të informuara në lidhje me përdorimin e energjisë. Duke ndjekur këto

udhëzime, konsumatorët do të kenë informacione më të mira që u nevojiten për të reduktuar kostot që lidhen me konsumin e tepërt të energjisë elektrike.

- **Si i fuqizoni konsumatorët për të marrë vendime të informuara?**

Që vendimi të arrijë siç duhet te konsumatori fundor, ne kemi vënë në zbatim praktika rregullatore që ofrojnë akses të detajuar të informacionit për të gjitha palët e interesuara. Politika jonë e komunikimit ka prioritet përfshirjen e qytetarit në procesin e politikë-bërjes duke angazhuar të gjithë palët e interesuara në një fazë të hershme. Para se të merret një vendim rregullator në lidhje me miratimin e një regjimi të ri tarifor ose ndryshime tek legjislacioni sekondar, ERE merr masat e nevojshme për të lehtësuar proceset e konsultimit siç janë seancat dëgjimore dhe sigurohet që dëgjojnë interesat e konsumatorëve përgjatë procedurës së hartimit të politikave.

Strategjia jonë për fuqizimin e konsumatorit përfshin shpërndarjen e informacionit dhe kryerjen e fushatave për çështje të përgjithshme ose specifike, ofrimin e këshillave praktike për konsumatorët. Shembuj të fushatave tona përfshijnë informimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre duke ngritur pyetjet e mëposhtme dhe duke ju përgjigjur atyre:

- Cilat janë të drejtat e konsumatorëve fundorë?
- Si mund të bëhet lidhja me rrjetin e shpërndarjes?
- Cila është Procedura për ndryshimin e furnizuesit?
- Çfarë informacioni duhet të permbaje fatura e energjisë elektrike, si mund të paguhet fatura e energjisë elektrike?

Një mënyrë tjetër që ne jemi munduar të përdorim për qëllimin tonë për të fuqizuar konsumatorin është përmes edukimit të konsumatorit.

Ne e konsiderojmë të domosdoshëm bashkëpunimin me organe të ndryshëm për edukimin e konsumatorit. Tek strategjia jonë e komunikimit kemi identifikuar bashkëpunimin me OJQ, Universitete, organizata biznesi dhe organe të tjera publike, për të patur një bashkëpunim të dukshëm për të edukuar konsumatorin. Ne i shikojmë ato si një urë komunikimi dhe po ashtu ku mund të prezantojmë informacionin dhe nevojat e qytetareve, grupeve në nevojë dhe audiencave të veçanta. Ato mund të jenë pjesë e politikë-bërjes dhe kërkimeve mbi politikat strategjike dhe zgjidhjeve alternative. Bashkëpunimi është krijuar përmes Memorandumeve me disa fakultete midis të cilave mund të përmendim Fakultetin Juridik, Ekonomik të Universitetit të Tiranës etj. Enti Rregullator i Energjisë për Shqipërinë është në proces nënshkrimi të Memorandumit me Agjensinë për Eficiencën e Energjisë për të ndërmarrë nisma të përbashkëta ndërgjegjësimi dhe fushata informimi për konsumatorët.

Po japim një shembull konkret mbi rolin se si një OJQ mund të japë koment për institucionet rregullatore ose publike:

-gjatë vitit 2022, Qendra Shqiptare e Konsumatorit ka kryer një monitorim tek institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi mbrojtjen e konsumatorit. Midis objektivave të monitorimit ishte

identifikimi i informacionit për mbrojtjen e konsumatorit përmes aksesit në faqet e tyre zyrtare. Në këtë monitorim, ERE është vlerësuar pozitivisht për identifikimin e informacionit për mbrojtjen e konsumatorit, duke theksuar seksionin "shërbime për konsumatorin" i cili funksionon mirë. Po ashtu, është identifikuar që brenda kornizës së mbrojtjes së konsumatorit, ERE ka siguruar një dritare (link) për pyetjet më të zakonshme që konsumatorët mund të kenë dhe ku janë përgjigjet e tyre. Gjithashtu, është përcaktuar rëndësia e ankesës dhe numri i linjës telefonike të ERE, duke mundësuar adresimin e ankesës në seksionin përkatës të këtij shërbimi, i cili gjendet lehtë në faqen e internetit të ERE.

- Cilat janë kanalet e komunikimit dhe çfarë informacioni ofrohet?

Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë dhe të gjerë të teknologjisë dixhitale, kemi përshtatur disa kanale për tu ofruar konsumatorëve akses në informacion. Qasja jonë përfshin përdorimin e disa platformave dixhitale si Instagram, Facebook, LinkedIn, për të shpërndarë informacionin e përgjithshëm në lidhje me të drejtat dhe tarifatat e konsumatorit, masat për kursimin e energjisë, protokollet për menaxhimin e ankesave, detajet e kontaktit për palët përkatëse, rregullat për ndryshimin e furnizuesit ose lidhjet me rrjetin si dhe standartet për cilësinë e shërbimit.

Si pjesë e angazhimit tonë në lidhje me transparencën dhe përgjegjshmërinë për politikat e shpërndarjes së informacionit, ne e përditësojmë rregullisht faqen tonë të internetit me informacione të reja. Këto informacione përfshijnë njoftime lidhur me vendimet e marra në mbledhjet e bordit të ERE, të përmbledhura për lehtësim kuptimi.

Po ashtu ne publikojmë broshura të përgatitura nga drejtoritë e ndryshme të ERE që ofrojnë kuptim më të gjerë për aspektet kryesore që lidhen me veprimtarinë e ERE.

Për më tepër, ne mbajmë raporte të përditësuara që përfshijnë analizat e të dhënave javore, mujore dhe tremujore së bashku me Newsletter mujore ku përfshihen zhvillimet më të fundit të lajmeve dhe veprimtarive të ERE.

Në përgjithësi, qëllimi ynë është i qartë: Të sigurojmë që aksesit i informacionit që i ofrohet konsumatorit është i saktë dhe i besueshëm, pra ajo që konsumatori ka nevojë për konsumin e energjise elektrike, në mënyrë që ata të bëjnë zgjidhje të informuara për mënyrën se si të menaxhojnë konsumin e tyre duke qënë të informuar mbi rregulloret respektive në fuqi.

3. A bashkëpunoni me palët e tjera të interesuara ose institucione të tjera për të mbrojtur interesat e konsumatorit?

Si pjesë e angazhimit tonë për të mbrojtur të drejtat e konsumatorit, ne angazhohemi në përpjekje bashkëpunuese me shumë palë të interesuara, përfshirë organet publike dhe autoritete të tjera. Sipas dispozitave ligjore ERE është e detyruar të punojë ngushtë me Ministrinë e Energjisë si dhe Autoritetin e Konkurrencës, Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Organizma të ndryshëm Jo Qeveritarë (OJQ). Për shembull, kur trajtohet një rast tarifash që vjen në ERE për shqyrtim, ne kërkojmë konsultimin nga Ministria e Energjisë edhe nga Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me

tarifat e aplikimit të të licensuarit. Po ashtu para se të marrim ndonjë vendim në lidhje me përcaktimin e tarifës ose modifikim të saj, ne zhvillojmë seanca degjimore publike ku të gjithë palët e interesuara kanë mundësinë për të shprehur pikëpamjet e tyre.

Për më tepër vlen të theksohet që ne bëjme përpjekje të përbashkëta për të siguruar transparencën duke kërkuar komentet publike në lidhje me aktet e reja nënligjore ose modifikimin e atyre ekstuese. Nëpërmjet këtyre konsultimeve dhe angazhimeve me palët përkatëse të interesuara nga sektorë të ndryshëm të shoqërisë - qofshin ata qeveritarë ose jo-qeveritarë - synojmë jo vetëm të mbrojmë konsumatorët por edhe të promovojmë një proces vendimmarrje gjithëpërfshirëse ku zëri i të gjithëve të dëgjohet njësoj.

4. Si siguroheni që faturat e energjisë janë të kuptueshme dhe reflektojnë një informacion të saktë për konsumatorët se si llogaritet kosto e energjisë elektrike?

Formati dhe përmbajtja e faturës kryesore janë të përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për Sektorin e Energjisë Elektrike. Sipas dispozitave ligjore, furnizuesit duhet të komunikojnë në mënyrë të qartë me konsumatorët përmes faturave të konsumit të energjisë elektrike ose materialeve promovuese në lidhje me:

- Të dhënat që i takojnë çdo burimi energjie të siguruar nga ata gjatë vitit të kaluar;
- Komponentët kryesore të çmimit dhe kostot e tyre respektive; etj.

Ministria e Financave mbikqyr zbatimin e rregullave të përgjithshme lidhur me faturat. Përveç kësaj, ERE ka vendosur detyrimet për furnizuesit për të siguruar të dhëna specifike në fatura duke përfshirë detajet e furnizuesit, emrin e konsumatorit, adresën e faturimit, adresën e furnizimit, numrin e matësit, llojin e matësit të përdorur, datën e lëshimit dhe afatin e pagesës së bashku me detajet mbi periudhën për paraqitjen e ankesave në lidhje me faturimin.

Sipas legjislacionit që drejtojnë Sektoret e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror në Shqipëri përkatësisht legjislacioni ("Për Sektorin e Energjisë" dhe "Për Sektorin e Gazit Natyror"), ERE ka të drejtën ligjore për të trajtuar ankesat e konsumatoreve, si dhe për të ndërmjetësuar mosmarrëveshjet midis licencuarëve ose për të zgjidhur çështjet midis licencuarëve/konsumatoreve/përdoruesve të sistemit që kërkojnë akses në rrjet. Megjithatë, duhet theksuar se procesi rregullator nuk përfshin ankesat lidhur me shkelje penale ose ato që janë në procedurë gjyqësore. Po ashtu, ERE ka miratuar rregulloret që merren me trajtimin e ankesave të konsumatoreve nga të licensuarit që operojnë në të dy sektorët (energji elektrike /gaz natyror). Rregullat që udhëzojnë procedurat për ankesat bëhen publike nga të dy subjektet furnizuese si dhe vetë ERE.

Rregullatori shpesh organizon pyetësorë për të aksesuar dhe trajtuar më mirë informacionin që nevojitet më shumë nga konsumatori mënyrën më e mirë që ky informacion të arrijë tek konsumatori. Pyetësorët trajtojnë pyetje si:

- Sa të kënaqur jeni me shërbimin që merrni nga furnizuesi?
- Për çfarë informacioni keni më shumë nevojë?
- Cilat janë mjetet me të cilat dëshironi të informoheni?
- Sa efektiv është informacioni që merrni nga furnizuesi ose rregullatori?

Ne i konsiderojmë këta pyetësore si hapin e parë për të marrë një perceptim mbi nevojat, vlerat dhe prioritetet e konsumatorit dhe për të identifikuar çdo pengesë që duhet tejkaluar.

5. Duke patur parasysh se një nga detyrat e rregullatorit është të mundësoje sigurinë e furnizimit për konsumatorët, mund të na tregoni se çfarë është duke bërë ERE për të lehtësuar diversifikimin e burimeve të energjisë dhe për të përmirësuar integrimin e tregut rajonal?

Struktura themelore e sektorit të energjisë elektrike së bashku me funksionet dhe detyrat kryesore (përfshirë ato të ERE) parashikohen tek legjislacioni primar. Ne e shohim rolin e autoritetit rregullator në vend në zbatimin e operimit të tregut, diversifikimin e burimeve të energjisë dhe bashkëpunimit rajonal përmes vendimeve përkatëse rregullatore për tu ofruar konsumatorëve sigurinë në furnizimin me energji elektrike me çmime të arsyeshme.

Një dimension tjetër në funksionimin siç duhet të tregut lidhet me transpozimin e vendimeve rajonale rregullatore, të cilat mbulojnë rregullat e licensimit, zhvillimin e rrjetit dhe standarte të tjera teknike. Për këtë qëllim, një aspekt i rëndësishëm në integrimin e tregut rajonal është bashkëpunimi rajonal. Në Shqipëri, ERE ka qene aktive në nismat për finalizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të cilat kontribuojnë në unifikimin dhe forcimin e marrëdhënieve me vendet fqinje. Së fundmi në Nëntor 2023, Rregullatorët, OST, dhe Bursa e Energjisë për Shqipërinë, Greqinë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkimin e Tregut të Energjisë për Ditën në Avancë në Europën Juglindore. Memorandumi u nënshkrua me iniciativën e Agjensisë Amerikane për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) dhe u mbështet nga Shoqata Kombëtare e Rregullatorëve të Shërbimeve Publike (NARUC), Shoqata Amerikane për Energjinë (USEA) dhe Instituti i Trekëndëshit të Kërkimeve Ndërkombëtare" (RTI international). Një nga objektivat e kësaj marrëveshjeje është të mundësojë koordinimin dhe përdorimin optimal të burimeve të energjisë në rajon. Para kësaj, në Dhjetor 2021, një tjetër Memorandum Mirëkuptimi u nënshkrua midis Rregullatorëve të Kosovës dhe Shqipërisë për Njohjen e Përbashkët të licensave të tregtimit dhe furnizimit. Gjithashtu, në vitin 2020, Rregullatorët dhe OST e Kosovës dhe Shqipërisë nënshkruan Memorandumin e Mirekuptimit për Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Sipas Memorandumit të Mirëkuptimit, rregullatorët e Kosovës dhe Shqipërisë ranë dakord për njohjen e përbashkët të licensave, që ka një ndikim tek ulja e kostos administrative për të licensuarit që operojnë tek të dyja tregjet.

Pas kësaj marrëveshjeje ERE miratoi ndryshimet tek rregullat e procedurave të licensimit dhe ato për njohjen reciproke të licensave. Po ashtu në Dhjetor 2022, ERE ka miratuar rregullat e përbashkëta për funksionimin e AlpeX. Para kësaj ne po ashtu miratuam rregullat e harmonizuara

te Zyrës së Koordinuar të Ankandit (CAO) për kufijtë Shqipëri – Greqi, Shqipëri – Mal i Zi dhe Shqipëri – Kosovë.

Të gjitha këto së bashku ndihmojnë për një akses më të madh për të ulur kostot e energjisë elektrike për konsumatorët fundore dhe nismat për integrimin e tregut rajonal.

6. Cilat janë sfidat kryesore dhe kufizimet që po përballeni në mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe a po e ndihmon dhe mbështet MEDREG institucionin tuaj (ERE) në lidhje me këto objektiva?

Sikurse përmendur më sipër, “Legjislacioni për Sektorin e Energjisë Elektrike” e trajton mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Aktualisht ka mekanizma kompensimi për këta konsumatorë dhe Ministria ka filluar procesin e miratimit të kriterëve dhe procedurave për ta marrë këtë status. Sapo të miratohet, ERE do të vazhdojë me miratimin e masave përkatëse bazuar tek këto rregulla të reja, ndërkohë që do të vazhdojë të punojë për mekanizma të tjera për konsumatorin siç janë shpërndarja e të dhënave dhe kostove për konsumin e energjisë elektrike.

Përveç ofrimit të informacionit për të dhënat e konsumit të energjisë elektrike dhe kostove të lidhura me këto, qëllimi i ERE është bashkëpunimi me qeverinë për aktivitete edukuese.

Objektivi kryesor i çdo organi rregullator është të arrijë një balancë midis mbrojtjes së interesave të konsumatorit, çështjeve financiare të investitorit dhe objektivave të shtetit.

Mbrojtja e interesave aktuale dhe atyre në të ardhmen të konsumatorit në lidhje me shërbimet e ofruara brenda tregjeve të tyre përfshin jo vetëm tarifa të arsyeshme që reflektojnë shpenzimet në mënyrë të saktë, por edhe mbështet vendimmarrjen e informuar midis konsumatorëve duke siguruar që ata e kanë kuptuar si duhet operimin e tregut kështu që mund të marrin pjesë në mënyrë aktive si konsumator prodhues (prosumers).

ERE synon të forcojë angazhimin e saj drejt integritit të tregjeve kombëtare të energjisë në dimensione rajonale nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me palët e interesuara, duke përfshirë operatorët e rrjetit, rregullatorët fqinjë dhe duke i dhënë prioritet transparencës së nevojshme ndaj palëve të interesuara.

Në përfundim, ne i kushtojmë vëmendje të veçantë partneritetit tonë me organizatat ndërkombëtare, siç është pjesëmarrja jonë tek MEDREG.

Pjesëmarrja jonë tek MEDREG ofron një platformë ku mund të diskutojmë praktikat më të mira në lidhje me çështje të përbashkëta midis vendeve të Mesdheut. Ne besojmë se kjo organizatë përbën një urë të rëndësishme për të përmirësuar kapacitetin tonë institucional, pasi ajo plotëson mungesën e njohurive në lidhje me potencialet e energjisë nëpër vende të ndryshme, duke promovuar njohurinë e përbashkët midis rregullatorëve nga vendet përkatëse.

*Empowering Mediterranean regulators
for a common energy future*

Follow us on



www.medreg-regulators.org

Via Lazzaretto, 3. 20124 Milano - Italy

info@medreg-regulators.org

+39 340 293 80 23



Co-funded by
the European Union